



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna Drenas/Gllogoc
Kuvendi i Komunës



Nr. 02-060-23906 dt. 19 05 2023

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Gllogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Milaim Hajdari, më datë: **26.05.2023**, (Ditë e Premte) duke filluar në ora **10:00** në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas i mbajtur më dt. **20.04.2023**.
2. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit 02 Nr.400/01-14929 të datës 28.03.2023, të Kuvendit të Komunës së Drenasit
3. Propozim vendim për miratimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit Gllogoc.
4. Propozim vendim për kompensimin e anëtarëve të Komisionit për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në Komunën e Drenasit.
5. Propozim vendim për rialokim të mjeteve financiare nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
6. Propozim vendim për rritjen dhe bartjen e të hyrave Vetanake.
7. Propozim vendim për rialokim të mjeteve financiare nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
8. Të ndryshme.

Drenas, 19.05.2023



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Zyra e Kuvendit



Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 19.05.2023, si vijon:

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa, ku prezantoi rendin e ditës dhe theksoi se kemi edhe dy pika shtesë:

1. Propozim vendim për rialokim të mjeteve financiare nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
2. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit 02 Nr.400/01-14929 të datës 28.03.2023, të Kuvendit të Komunës së Drenasit.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim rendin të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 06 vota “Për” kundër nuk pati, 1 “abstenim” u rekomandua për kuvend rendi i ditës.

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 13.04.2023.

Nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota “Për”, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

2. Propozim vendim për miratimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit –Drenas/Gillogoc.

Pas diskutimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 05 vota “Për”, 1 kundër, 1 abstenim.

3. Propozim vendim për kompensimin e anëtarëve të Komisionit për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

Anëtarët e KPF-se lidhur me propozimin në fjalë rekomanduan zyrës së kryetarit që të ndryshohet Propozim vendimi neni II, ku thotë: anëtarët e komisionit do të kompensohen për punën e kryer me shumë prej 50 euro për çdo ditë pune, ndërsa KPF-ja propozoi që për secilin anëtar pagesa të jetë për gjithë punën e kryer vetëm 300 euro.

Pas sugjerimeve të marra nga KPF-ja kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 06 vota “Për”, kundër nuk pati, abstenim nuk pati. Hamit Haxhiu nuk votoj.

4. Propozim vendim për Rialokim të mjeteve financiare në Shërbimet e Shëndetësisë.
Nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota "Për", kundër nuk pati, abstenim nuk pati.
5. Propozim vendim për rritjen dhe bartjen e të hyrave Vetanake.
Nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 02 vota "Për", 4 kundër, 1 abstenim.
6. Propozim vendim për rialokim të mjeteve financiare nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
Nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 05 vota "Për", 1 kundër, 1 abstenim.
7. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit 02 Nr.400/01-14929 të datës 28.03.2023, të Kuvendit të Komunës së Drenasit.
Nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 06 vota "Për", kundër nuk pati, 1 abstenim.
8. Të ndryshme.
Pati disa kërkesa nga anëtarët e KPF-së.

Pasi përfunduan diskutimet mbledhja përfundoi në ora 10:55



Kryesuesi i Kuvendit
[Signature]
Milaim Hajdari



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-23377 dt. 17.05. 2023

PROCESVERBALI

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: **20.04.2023**

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal-Milaim Hajdari

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 29 anëtarë: Labinot Halilaj (PDK), Bekim Lestrani (PDK), Arigon Sinani (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Laurita Muhadri Bujupi (PDK), Hamit Kastrati (PDK), Blerina Gashi (PDK), Gani Krasniqi (PDK), Fatmir Baliu (PDK), Qendrim Mulaj (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Agnesë Kastrati (PDK), Albulena Saliuku (PDK), Mirlinda Dvorani (PDK), Valentina Leku (PDK), Sali Dvorani (DD) Mergim Pirraku (DD), Mehedin Salihu (DD), Hamit Haxhiu (DD), Jahir Hajdari (DD), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Marigona Bazaj (DD), Florentina Elezi-Veliu (VV), Filloreta Bujupi (VV), Drin Halilaj (VV), Egzona Terrdevci (VV), Arbër Halilaj (GREEN), Beqir Kiqina (AAK), Egzon Qorri (LDK). Mungoi Muhamet Kurtaj.

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt. 28.03.2023
2. Propozim vendim për transfer të mjeteve nga Projekti, nr.10/611/850010/300/53732/0820, Kategoria e Shpenzimeve Kapitale në Projektin nr 10/611/850010/300/89114/0820 në buxhetin e drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport;
3. Propozim vendim për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake .
4. Propozim vendim për miratimin e Planit Komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integritit të huajve në Komunën e Drenasit/Gllogocit.
5. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit të kuvendit të komunës2-Nr.030/01-14940 të dt. 28.03.2023.
6. Të ndryshme.

Të enjten me dt. 20.04.2023 është mbajtur mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Drenasit, ku për diskutim ishin 7 pika për rend dite.
Mbledhja është kryesuar nga kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari.

Në mbledhje morën pjesë, Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, nënkryetari Arben Shala, drejtor të drejtorive komunale, zyra e informimit.

Më poshtë ju elaborojmë pikat që janë diskutuar e miratuar me shumicë votash në mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit njoftoi me rendin e ditës anëtarët e Kuvendit Komunal, theksoi se kemi edhe një pikë shtesë për rendin e ditës: Raporti Financiar Janar-Mars 2023.

Florentina Elezi-Veliu, në Komitetin për Politikë e Financa e kam propozuar që me hy në rend dite edhe një pikë në lidhje me barnatoret, ju keni premtu që gjatë javës keni me u marrë me procedurat ndërsa nuk ka lëvizë asgjë, dashta me ditë se ku jemi ?

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ne jemi interesuar, nuk kemi të drejt të bëjmë propozim vendim, këtë çështje e rregullon Ministria e Shëndetësisë bashkë me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik orarin e barnatoreve kështu që ne nuk mundemi me ndryshu asgjë aty për këtë arsye nuk kemi sjellë propozim vendim.

Egzona Tërdevci, propozoi që Raporti Financiar Janar-Mars 2023, të shtyhet për një seancë tjetër, nuk kam asnjë problem për raportin financiar por nuk mundemi me e analizu kur vjen sot materiali.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ju kërkoj që pikën e rendit të ditës për raportin financiar ta votoni, është raport tre mujor i cili nuk votohet ka ardh sot për arsye se nuk mundemi me e shty deri në muajin tjetër nuk ka asnjë gjë që duhet ta analizoni, i kemi edhe tri mbledhje tjera që do të diskutohet raporti gjashtë mujor, nëntë mujor, një vjeçar, raporti i përgjithshëm.

Pas këtyre diskutimeve kryesuesi hodhi në votim Raporti Financiar Janar-Mars 2023 që të hyn në rend dite: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, **(Për)** votuan 13 anëtar, 4 vota kundër 12 vota abstenim, u miratua që kjo pikë të hyn në rend dite.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hodhi në votim rendin e ditës se bashku me pikën shtesë që u miratua më lartë, nga 30 anëtar prezent, 26 votuan **(Për)**, 04 vota Kundër, dhe asnjë abstenim, miratohet rendi i ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 23.02.2023.**

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, **(Për)** votuan 30 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Propozim vendim për transfer të mjeteve nga Projekti, nr.10/611/850010/300/53732/0820, Kategoria e Shpenzimeve Kapitale në Projektin nr 10/611/850010/300/89114/0820 në buxhetin e drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.**

Egzona Tërdevci, ndërtimi i qendrës multifunksionale kulturore është një nga premtimet elektorale të z. Lladrovci në fushatën e vitit 2021, nuk e kuptoj planifikimin e bartjes se mjeteve nga ky projekt kur ende s'ka fillua shpenzimi i asnjë mjeti të këtij projekti. Nëse kthehmi tek çështja e ndërtimit të stadionit gjithsej planifikimi buxhetor në bazë të buxhetit që e kemi miratuar në gusht të vitit 2022 për vitet 2023-2025 është 240 mijë euro dmth e tejkalon shumë që ju e keni planifikuar me bart prej 300,000.00 €, ky propozim për bartjen tregon se nuk e keni problem t'i ndërroni premtimet elektorale po ashtu tregon që keni edhe mungesë të theksune të menaxhimit dhe të planifikimit dhe si rezultat ne si subjekt e votojmë kundër këtë propozim.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, sa i përket qendrave multifunksionale ne do ta bëjmë në shesh është i paraparë për shesh dhe do ta vendosim në buxhetin e sheshit dhe këto mjete për mos me i humb të cilat nuk mundemi me i zhvillu të cilat kanë qenë të parapame i kemi kalu tek stadioni i komunës tonë, stadioni ka nevojë edhe për 4-5 milion e kemi diskutuar edhe në Komitet për Politikë dhe Financa ju ftoj me votu, buxheti është i komunës tonë dhe investimet bëhen në komunën tonë, stadioni është një stadion i cili po ia ka lakmi Kosova po besoj se edhe komuna jonë do të mbërrij me i kthi klubet e veta në superlig dhe ka nevojë shumë për më zhvillu stadionin deri në fund, pra këto 300,000.00 €, janë aq pak sa ka nevojë me investu deri në përfundimit e projektit.

Egzona Tërdevci, është dashtë ta jepni këtë arsytim tek pjesa e arsytimit që e keni bërë, që do të përfshihet në buxhetin e sheshit, gjë që nuk e keni bërë, arsytimi është tepër i mangët.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, "Për" votuan 24 anëtar, 3 vota "kundër", 2 vota "abstenim" nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim vendim për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake.**

Shyqiri Bublaku, Drejtor i Financave- sa i përket propozim vendim për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake të vitit 2022 në vitin 2023, e kemi hartu propozim vendimin dhe shumat e përcaktuara, ne kemi pas në vitin 2022 një tejkallim të hyrave vetanake prej 1,146,544.88 euro shumë kjo e cila duhet të rritet dhe të bartet në këtë vit nga fondi 21 në shumë prej 270,627.97 euro, dhe nga fondi burimor (22) të viteve të kaluara nga viti 2021 në shumë prej 207,435.27 euro, këto mjete do të barten në këto kategori ekonomike:

Mallra dhe Shërbime 406,722.96 euro

Shpenzimet Komunale24,000.00 euro

Subvencione dhe Transfere 29,853.81

Shpenzime Kapitale1,164,031.35 euro. Të gjitha kategoritë do të barten në programet e caktuara të cilat janë të shënuara edhe në propozim vendim.

Mehedin Salihu, kjo bartje dhe kjo shpërndarje u bë në sektorë të veçanta është bërë në bazë të kërkesës se psh. Në sektorin e shëndetësisë janë bart vetëm 6.000 euro, është një shumë e ulët për sektorin e shëndetësisë.

Shyqiri Bublatku, Drejtor i Financave- shumat e buxhetit të cilat janë për arsim dhe për shëndetësi janë grande specifike të tyre dhe ato barten decidivisht në programet e caktuara, shuma e mjeteve të bartura për sektorin e juaj është shumë që ka mbet 6 mijë euro dhe e njëjta është bartë, kërkesat tjera prej programit të juaj nuk kemi pas, prej qendrës për punë sociale prej QKMF-së nuk kemi pas kërkesa për rritje apo për kërkesa shtesë e dhe në bazë të tyre dhe janë bërë bartja e tyre.

Mehedin Salihu, a është bërë në bazë të kërkesës së menaxhmentit apo ju e keni shpërndarë kështu, sepse kjo shumë është e pamjaftueshme për nevojat që i ka shëndeti primar.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, këto janë mjete të hyrave vetanake për investime kapitale, na këto investime kapitale i kemi të parapame mjetet që janë votu vitin e kaluar që u miratu buxheti, ndërsa këto janë të hyra vetanake të cilat i kemi shpërndarë në bazë të kërkesave të drejtorive përkatëse.

Labinot Halilaj, propozim vendimi nuk ka edhe shpalosje, thuhet psh 54 mijë euro zyra e kryetarit nuk e dina për çka kanë më u shfrytëzuar për zyrën e kryetarit, tek dy kategoritë e tjera në kategorinë e shpenzimeve komunale nën programin infrastruktura rrugore janë afër 24 mijë, zgjerimi dhe ndërtimi i i sheshit “Fehmi dhe Xhevë Lladrovci” në Drenas një pozicion thotë që shuma është 900,000.00 €, në kategorinë e shpenzimeve kapitale të nënprogramet dhe projekteve si në vijim në Drejtorinë e Infrastrukturës Publike prapë thotë zgjerimi dhe ndërtimi i i sheshit “Fehmi dhe Xhevë Lladrovci” në Drenas kodi 492 vlera 108 mijë dmth diku përafërsisht është mbi 1 milion e 8 mijë të planifikuara për Zgjerim të sheshit, ndoshta është shumë më e nevojshme që qytetari ka shumë e shumë kërkesa tjera qoftë për trotuare, qoftë për kanalizim qoftë për ndriçim, se sa ka nevojë për zgjerim të sheshit, dhe ajo që është në interes, seancën e kaluar e kena aprovu planin rregullativ të qytetit, unë mendoj që plani rregullativ i qytetit ka me pas implikime buxhetore, ne e shohim që rrugët në këtë gjendje që çfare janë janë kogja pengesë për funksionimin e tyre, e nëse më një plan rregullativ ish dashtë me pas ndryshim të rrugëve, rrugicave është dashtë shumë ma mirë me u planifikua këto mjete se sa qysh janë planifikua në këtë mënyrë, unë personalisht nuk jam “Për” të këtij propozim vendimi.

Shyqiri Bublatku, Drejtor i Financave- sa i përket shumës që e përmende tek zyra e kryetarit për mallra dhe shërbime janë dy kontrata, është asociacioni i komunave të cilat paguhen prej zyrës së kryetarit dhe shuma vjetore e saj është bukur e lartë, plus e kemi token që e kemi marrë prej hekurudhës për parking të automjeteve dhe ajo shumë duhet të mbulohet prej këtyre mjeteve, ndërsa sa i përket zgjerimit të sheshit pse është qit në dy pozicione shuma prej 900,000.00 €, është shumë e cila është e rritur nga të hyrat vetanake e viti 2022 ndërsa shuma shuma prej 108 mijë euro është shumë e bartur prej vitit të kaluar kanë qenë mjete të pa shpenzuara të cilat kanë mbet dhe janë orjentu duke u bazu në kërkesat e programeve dhe nënprogrameve dhe nevojave të tyre, ata gjithherë bazohet në kërkesat e qytetareve të cilat i bijnë në programe dhe nënprograme dhe sigurisht që ato janë implementu në bazë të kërkesave të tyre.

Labinot Halilaj, unë jam në rregull me gjithë diskutimin tënd, mirëpo unë prap po e them që shumë ma shumë ka nevoja të tjera se sa që janë orjentu në këtë drejtim.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, qytetareve ju kemi bërë thirrje për trotuare ku kemi hapësira publike ku mundemi me ndertu trotuare, as një metër nuk e le pa u ndertu, prona

private nuk muj me shpronëse sepse nuk kemi buxhet për atë qëllim. Sa i përket kanalizimeve kane mbet edhe 4-5 km me e perfundu rrjetin e ujerave te zeza të kanalizimeve. Sa i përket ndriçimit ju e dini që dy vjet ska punu OSHP-ja dhe kontrata ka fillu të zbatohet dhe besoj që 90 % e krejt lagjeve, fshatrave, qytetit do të jetë e mbuluar me ndriçim, sa i përket rrugëve dhe rrugicave i kemi përmbyll, unë jam shumë i lumtur që sot pres me fillu me u dhënë në shpallje objekti i ri i QKMF-së nga Ministria e Shëndetësisë por dhe zhvillimi i projekteve tjera, sa i përket sheshit ju e dini që i kemi 237 mijë euro të grandit të performances dhe sigurisht që na duhen edhe 2 milion apo 2 milion e gjysmë nuk e di ofertat që do të vijnë, ne jemi të detyruar që projekti i fituar nga performanca të zhvillohet deri në fund dhe kërkoj që ta votoni buxhetin, prandaj ky buxhet është për zhvillimin e komunës për një ndërtim të parkut që ka me qenë shembull jo vetëm për qytetet e Drenasit por ka me qenë shembull për krejt qytetet e rajonit.

Labinot Halilaj, unë mendoj që edhe sheshi akutal është i mjaftueshëm e le më zgjerimi i sheshit, shumë më të nevojshme janë që këto mjete të orientohen projekte që janë me më nevojë për qytetarin e Drenasit.

Mehedin Salihu, shpenzimet kapitale nëse e shohim raportin ka ndryshime shumë të madhja psh tek kanalizimi i ujërave të zeza për fshatin Shtutice, Verboc dhe Polluzhë janë afër 2 mijë euro investim, kërkoj një sqarim a është gjendja me e mirë në ato fshatra apo çka ka ndodh?

Shyqiri Bublaku, Drejtor i Financave- sa i përket raportit financiar i kemi të ndara secilin projekt të veçantë veç e veç dhe programet dhe vendin se ku do të zhvillohet, ne jemi duke e diskutuar propozim vendim për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake dhe jo për raportin financiar.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ne e kemi votuar buxhetin dhe i kemi mjetet që po kërkojnë, psh një projekt i kanalizimit ne e kemi llogarit sa e kemi parapare vitin e kaluar dhe i kemi shtu edhe ato mjete të atij projekti, këto janë shtesa që i kemi për mos me lënë me deshtu projektin të cilën e kemi.

Arbër Halilaj, unë si asamblist dhe bashkëthemelues i GRREN do duhet të isha gjithmonë "Për" kur ka të bëjë me projekte të kësaj natyre të sipërfaqeve gjelbërre mirëpo mendoj se një projekt kaq madhor ka mungu debati me qytetar dhe ka edhe pakënaqësi nga qytetarët dhe bizneset te cilat i kanë shpreh direkt, e kam shiku një ankesë të tyre drejtuar Kuvendit Komunal Drenas, dhe gjithmonë kur ka këso pakënaqësi nga ndonjë pale e interesit mendoj se ato duhet te tejkalohen me një debat te singertë dhe transparent për çka edhe komuna jonë është e njohur, dhe derisa ka këso ankesa unë jam kundër këtij projekti dhe nuk e di cili është prioriteti që ky projekti shtyhet kur besoj që për Drenasin është i mjaftueshëm sheshi ekzistues për komunën tonë dhe ka projekte tjera shumë ma prioritete. Unë votoj "kundër"

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ankesa ka pas prej bizneseve dhe brenda ditës ju kam kthi përgjigje dhe pastaj kane kërkuar takim i kam prit ne takim dhe unë jam në rregull me ata, por projektet e mëdha të komunës nuk mund të bllokohen nga një individ apo nga një biznes sepse interesi i qytetarit është më i madh, pra kemi pas debat për këtë çështje edhe për shesh janë kry këto procedura është plan zhvillimor edhe në hartë zonale. Ju ftoj me e votu dhe besoj që do të jeni krenar me një shesh që do të ndërtohet.

Hamit Haxhiu, nuk jemi ne kundër sheshit kryetar, se Drenasi ka shesh të mjaftueshëm për numrin e qytetareve që e ka, neve na intereson kushtet më elementare për qytetarët tonë që

t'i mbajmë që të mos i lëshojnë vendet rurale, 1 milion euro për shesh, është nder komuna që ka sheshin ma te madh sa i përket qytetareve të asaj komune, ne si grup i asamblesë komunale të DD jemi kundër kësaj pike.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, me thoni ku ti dërgoj unë këto mjete unë pajtohem nëse ju me bindni që duhet me i dergu tjetër kund, por ju duhet me pas ide, duhet me pas projekt, pra një shesh i cili do të ndërtohet prej Raiffeisen Bank e deri tek rruga "Xhevat Demaku" është një projekt i jashtëzakonshëm që ia rrit vlerën jetës së qytetareve të Drenasit dhe që e mban qytetarin e Drenasit me jetu në Drenas.

Labinot Halilaj, për hir të qytetareve, nuk qëndron ajo se nëse ne nuk investojmë në shesh i humbin grandet që i kemi marrë si komuna me performancë më të mirë, plani rregullativ i qytetit ka me pas implikime buxhetore

Hamit Haxhiu, qytetarët nuk kanë as ujë të pijes, tregona që veq një projekt që ke fillu dhe e ke përfundu brenda dy mandateve tuaja që e ke përfundu?

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, unë raportimet i bejë dhe dha përgjigje, nuk ka projekt që ka qenë i komunës që nuk e kam zhvillua, unë po thujse se krejt ato që ma kanë taku për ujësjellës në Komunën e Drenasit i kam kry, as nuk ka mundësi as nuk mundet me e kry komuna projektin e fabrikës për përpunimin e ujerave të zeza, projektet jemi duke i zhvillua, nuk ka projekt që nuk u zhvillua.

Bekim Lestrani, mjetet e grandit të performances janë mjete të qytetarit të komunës tonë këto janë të parapame me u investua në projekte që janë në të mirë të qytetareve, unë kisha kërku që këto mjete t'i orjentonin tek ujt e pijes, në trotuare, tek ujerat e zeza, ujerat e zeza në shumicën e fshatrave nuk kanë përfundu e kam fjalën për lidhjet sekondare, është e çuditshme që ne me pretendua me e ndertu një shesh të tillë kur kemi nevoja shumë themelore të qytetareve, i ftoj koleget që mos ta votojnë këtë ndryshim të alokojme në mënyrën e duhur buxhetin e komunës tonë.

Pas këtyre diskutimeve, vërejtjeve dhe sugjerimeve që u dhanë kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, "Për" votuan 15 anëtar, "kundër" 14 anëtar, abstenim nuk pati.

Sqarim:

Duke u bazuar në ankesën e ngritur nga asambleja komunale në grup të komunikimit në viber, për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim vendim për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake**, në mbledhjen e mbajtur me dt. 20.04.2023 e vërefikuar nga Sekretaria e Kuvendit përmes video-inqizimit konstatojmë se për pikën e tretë të rendit të ditës **Propozim vendim për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake, nga 29 prezent u miratua me: 14 vota (Për), 15 vota (Kundër) dhe asnjë abstenim**, është bërë inkorporimi (ndërrimi i numrave të votave) dhe Sipas kësaj konstatojmë se kjo pikë e rendit të ditës **nuk u miratua** në mbledhjen e rregullt të datës 20.04.2023.

Dërgimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt : **20.04. 2023**, në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, në MAPL, me përmirësime dërgohet në MAPL vetëm me tri vendimet e miratuara në mbledhjen e mbajtur me dt. 20.04.2023, ndërsa propozim vendimi i lartëcekur **Propozim vendim për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake** nuk dërgohet në zyrën ligjore të MAPL-së.

Dërgimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt : **20.04. 2023** dërgohet **vetëm** me këto tri vendime për MAPL.

1. Vendim për transfer të mjeteve nga Projekti, nr.10/611/850010/300/53732/0820, Kategoria e Shpenzimeve Kapitale në Projektin nr 10/611/850010/300/89114/0820 në buxhetin e drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport;
2. Vendim për miratimin e Planit Komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riadhesuar dhe integritit të të huajve në Komunën e Drenasit/Glllogocit.
3. Vendim për Shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 02-Nr.030/01-14940, të datës **28.03.2023**.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e katert të rendit të ditës: **4. Propozim vendim për miratimin e Planit Komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riadhesuar dhe integritit të huajve në Komunën e Drenasit/Glllogocit.**

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 21 anëtar, **“Për”** votuan 21 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit të kuvendit të komunës2-Nr.030/01-14940 të dt. 28.03.2023.**

Flutura Avdiu- Drejtoreshë e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, ne muajin e kaluar e kemi pas një propozim vendim për hapjen e shqyrtimit publik mirëpo ne bazë të ministrisë të te planifikimit hapësinor dhe infrastrukturës është thënë që në bazë të ligjit per planifikimin hapësinor nuk parashihet hapja e shqyrtimit publik për rregulloren e bonusit të zoonimit. Pra duhet të shkojmë direkt me miratim perfundmiar, ne kemi dasht të jemi më transparent 30 ditë ta mbajmë në shqyrtimin publik pjesëmarrjen e publikut ta kemi mirëpo kështu që na është lehtësuar puna më shumë, për këtë arsye e kemi shfuqizuar vendimi që në muajin tjetër ta bijmë vendimin për miratimin përfundimtar të rregullores.

Egzona Tërdevci, kërkoj një sqarim, ne dy herë kemi vendos me lënë në shqyrtim publik këtë rregullore edhe në seancën e 23.02.2023 dhe në seancën e muajit marsit me arsyetimin se e ka pru një vendim për shfuqizim ministria, nuk po e kuptoj nëse u kanë e arsyeshme me e qit ne diskutim publik pse është bërë dy herë e njëjta?

Flutura Avdiu- Drejtoreshë e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, herën e parë është bërë rishqyrtimi por ka qenë bashkë me planet rregulluese të hollësishme ndërsa kur është bërë rishqyrtimi publik i dy akteve në muajin e kaluar të planeve rregulluese që ka qene korrigjimi teknik dhe shtimi i neneve në këtë rast na ka ardh një vlerësim tjetër ku thotë ligji për planifikimin hapësinor dhe udhëzimet administrative nuk e parashohin hapjen e shqyrtimit publik për rregulloren e bonuseve të zoonimit pra ka ndërruar vlerësimi në rastin e dytë kështu që e shfuqizojmë vendimin dhe shkojmë më miratim përfundimtar.

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 21 anëtar, **“Për”** votuan 21 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Raporti Financiar Janar-Mars 2023.**

Shyqiri Bublaku-Drjtor i Financave, sa i përket raportin financiar është sjellë me vonesë sepse për këtë periudhë kohore i kemi pas zyrën kombëtare të auditimit dhe kemi qenë të ngarkuar, dhe jemi vonuar me hartimin e raportit financiar. Sa i përket performances se të hyrave për vitin 2023 kemi startuar shumë mirë se e bëjmë një krahasim paraprak të vitit paraprak kemi një tejkalim të realizimit të hyrave prej 55.72% krahasuar me periudhën e njëjtë të viti të kaluar. **Shpenzimet buxhetore** për këtë periudhë kanë arritur në shumë prej: 2,997,538.95,€ përgjatë tremujorit të parë të vitit 2023 apo 16.51 % të buxhetit të komunës për vitin 2023. **Shpenzimet për paga dhe mëditje** gjatë këtij tremujori, shënuan vlerën prej 2,451,727.15 €, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 27.13 % . **Shpenzimet në mallra dhe shërbime** Gjatë këtij tremujori vlera e këtyre shpenzimeve kanë arrit shumën prej: 241,114.48 € dhe kemi një rritje prej 15.04 % krahasuar me vitin 2022, **Shpenzime në komunalitet**, shpenzimet për këtë kategori kanë shënuar rënie dhe kanë arrit shumën prej: 48,358.03 € apo 64.91 % krahasuar me vitin 2022.Kjo shumë korespondon me 26,145.02 € ma pakë se viti paraprak i kësaj periudhe. **Shpenzimet për subvencione dhe transfere**, shënuan vlerën prej 17,479.50 € gjatë këtij tremujori, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 16.65 % krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar të kësaj kategori për këtë periudhë. Subvencionet dhe transferet, gjatë periudhës raportuese paraqitet një rënie prej 61.93%.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **7. Të ndryshme.**

Mehedin Salihu, pyeti rreth orarit të barnatoreve, ne e kemi një orar funksional në Drenas por unë mendoj se është i padrejtë, në Drenas veprojnë në këtë orar vetëm disa barnatore kurse një pjesë e madhe e barnatoreve tjera jo, një pjesë e barnatoreve që janë me orar i ngarkojnë festave edhe pse janë festa atyre ju bartet orari gjatë festave, unë jam për që kur të është festa me qenë vestë për atë ditë barnatorët private jo për shtetërore, por edhe disa barnatore tjera që punojnë pa orar mendoj se duhet me hy edhe ato në orar.

Petrit Gashi- Drejtori i Inspeksionit, gjitha barnatorët e kanë një momerandum të cilët kanë lidhur marrëveshje të përbashkët janë zotë për me respektua një orar të caktun, për disa barnatore që janë në lartësi me te madhe por janë të përcaktuar në lartësi prej institucionit shëndetësor të cilat i kanë, këtë problem e kemi edhe në Komoran jo vetëm në Drenas, Drenasi është shembull i respektimit të orarit qoftë të kujdestarisë qoftë të festave.


Mehedin Salihu, mua nuk më duket e drejt që me me ia mbyll lokalit njerëzve për katër dit, unë jam për me respektu festën në atë ditë që është festë ata nuk kanë të bëjnë me neve me bartjen e festave edhe ditëve të tjera ky ishte qëllimi, e sa i përket barnatoreve tjera perimetri është i lartë por edhe ata duhet me pas një orar, nëse vendosim orar për barnatore duhet me vendos për të gjitha, përderisa ajo është funksionale dhe e ka të njëjtën veprimtari të veprimit.

Petrit Gashi- Drejtori i Inspeksionit, barnatorët janë ato që e kanë përzgjedhë kriteret e momerandumit të bashkëpunimit se qysh kane me funksionua, dhe aty u diskutua edhe për festat zyrtare edhe për orarin gjatë dhe orarit gjatë natës dhe vikendeve, pra janë vet barnatorët përfaqësuesit e tyre që mundën me bë një momerandum të ri dhe me i ngrit këto shqetësime që ju po i ngritni sot në kuvend, për neve është e pa pranueshme që mos te ketë se paku një barnatore funksionale gjatë orarit të natës dhe vikendeve për tjera kriterë janë vet përfaqësuesit e barnatoreve që i përcakton.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur seancën, seanca përfundoj rreth orës 11:55 min.

Me gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit të datës 20.04.2023 mund të ndiqni në ueb faqen zyrtare të komunës, rrjetin social të Facebook-ut dhe në kanalin YouTube.

Procesmbajtëse:


Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Milaim Hajdari



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
KOMUNA E DRENASIT



Zyra e Kryetarit
01 Nr. 463/06-23009 dt. 16.05. 2023

Në bazë të nenit 58 pika h të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72.2 paragrafi (a) të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 53, paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031, si dhe në bazë të vendimit të ligjshmërisë nga MPL Nr.VI-020-290/13 të datës 15.05.2023, Kuvendi i Komunës së Drenasit/Gllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2023 të miraton këtë:

PROPOZIM – VENDIM
PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT 02 NR.400/01-14929 TË DATËS 28.03.2023, TË
KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT

I.

Të Shfuqizohet Vendimi 02 Nr.400/01-14929 të datës 28.03.2023 të Kuvendit të Komunës për këmbimin e pjesëve të njësive kadastrale në zonën kadastrale në Çikatovë të Vjetër dhe Gllogoc, për projektin e rregullimit të ngrohtorës së qytetit të Drenasit.

II.

Bazë për shfuqizimin e këtij vendimi është Kërkesa e MPL-së Nr VI- 020-290/13, datë 15.05.2023, për Rishqyrtimin e Ligjshmërisë së Aktit të Komunës së Gllogocit 02 Nr.400/01-14929 të datës 28.03.2023 për këmbimin e pjesëve të njësive kadastrale në zonën kadastrale në Çikatovë të Vjetër dhe Gllogoc, për projektin e rregullimit të ngrohtorës së qytetit të Drenasit

III.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

IV.

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale, si dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës.



KRYETARI I KOMUNËS:

Ramiz Lladrovci

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Drenasit me datë 28.03.2023 ka miratuar Vendimin 02 Nr.400/01-14929 për këmbimin e pjesëve të njësive kadastrale në zonën kadastrale në Çikatovë të Vjetër dhe Glllogoc, për projektin e rregullimit të ngrohtorës së qytetit të Drenasit

MPL në vlerësimin për ligjshmëri Nr.VI-020-290/13 të datës 15.05.2023, ka vlerësuar se Vendimi i Kuvendit Komunal të Drenasit 02 Nr.400/01-14929, i datës.28.03.2023 për këmbimin e pjesëve të njësive kadastrale në zonën kadastrale në Çikatovë të Vjetër dhe Glllogoc, për projektin e rregullimit të ngrohtorës së qytetit të Drenasit, nuk është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Andaj Kuvendi i Komunës së Drenasit do të rishqyrtoj edhe do të harmonizoj këtë vendim sipas kërkesës së MPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Milaim Hajdari, Kryesues e Kuvendit të Komunës së Glllogocit		
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë		
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL		
Nga:	Besim Myrtezani, zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL	Date:	19.04.2023 VI-020-290
Zyrtaret përgjegjës:	Gëzim Sahiti, Zv. Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Leonora Bajrami, Zyrtare për Monitorim të Komunave		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor			
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor			
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim		
Lloji i aktit:	Vendim i kuvendit të komunës së Glllogocit		

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi 02 Nr.400/01-14929 për këmbimin e pjesëve të njësive kadastrale në zonën kadastrale në Çikatovë e Vjetër dhe Glllogoc, për projektin e rregullimit të ngrohtores së qytetit të Drenasit
I miratuar më datë: 28.03.2023
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 28.03.2023

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në nuk është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Glllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë 28.03.2023, ka miratuar Vendimin 02 Nr.400/01-14929 për këmbimin e pjesëve të njësive kadastrale në zonën kadastrale në Çikatovë e Vjetër dhe Glllogoc, për projektin e rregullimit të ngrohtores së qytetit të Drenasit i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit.

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit është në kundërshtim me Rregulloren Nr. 09/2020, për Përcaktimin e Procedurave për Dhënin në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të komunës, përkatësisht nenin 31 pika 1.8 ku sqaron se pronat të cilat këmbehen nuk duhet të jenë nën hipotekë, në rastin konkret parcelat P-70315016-01013-0; P-70315016-00269-2 sipas certifikatës së pronësisë janë në hipoteke.

Andaj bazuar në të lartcekurat, Kuvendi i Komunës së Glllogocit, duhet që të ndërmerr veprime ta rishqyrtoj aktin 02 Nr.400/01-14929 për këmbimin e pjesëve të njësive kadastrale në zonën kadastrale në Çikatovë e Vjetër dhe Glllogoc, për projektin e rregullimit të ngrohtores së qytetit të Drenasit dhe harmonizoj sipas legjislacionit në fuqi.


Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbete në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Komuna Drenas/Glllogoc
Kuvendi i Komunës

02-Nr. 400/01-14 929, dt. 28. 03

2023



Bazuar në nenin 11,12,pika 1,pika 2,neni 14,pika 1 dhe neni 40, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34.pika 34.6, të Statutit të Komunës së Drenasit, që në bazë të nenit 29, Rregullorës (QRK) Nr.09/2020,për Përcaktimin eProcedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 24 dhe neni 25 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës nr.06/L-092, Kuvendi i Komunës së Drenasit/Glllogocit në mbledhjen e rregullt e mbajtur me datë, 28.03. 2023, miratoi këtë:

V E N D I M

Për këmbimin e pjesëve të njësive kadastrale në zonën kadastrale në Çikatovë e Vjetër dhe Glllogoc, për projektin e rregullimit të ngrohtores së qytetit të Drenasit

Neni 1

MIRATOHET Vendimi për këmbimin e njësive kadastrale si në vijim:

Propozimi i parë i pronave komunale për këmbim:

- P – 70315066-00829-1, zona kadastrale Çikatovë e Vjetër, – pronë komunale, KK Glllogoc.
- P – 70315066-00829-2, zona kadastrale Çikatovë e Vjetër, – pronë komunale, KK Glllogoc.

Propozimi i dytë i pronave komunale për këmbim:

- P – 70315066-00875-0, zona kadastrale Çikatovë e Vjetër, – pronë komunale, KK Glllogoc.
- P – 70315066-00876-0, zona kadastrale Çikatovë e Vjetër, – pronë komunale, KK Glllogoc.

Propozimi i tretë i pronave komunale për këmbim:

- P – 70315066-00881-0, zona kadastrale Çikatovë e Vjetër, – pronë komunale, KK Glllogoc.
- Pronat e Newco Ferronikeli Complex L.L.C. për këmbim:
- P – 70315016-00269-2, zona kadastrale Glllogoc, pronë private, pronar Newco Ferronikeli Complex L.L.C.
- P – 70315016-01013-0, zona kadastrale Glllogoc, pronë private, pronar Newco Ferronikeli Complex L.L.C.

Neni 2

Qëllimi për këmbimin e këtyre pjesëve të njësive kadastrale, pronës private me pronën komunale të cekur në pikën I të këtij propozimi, është realizimi i projekti për ndërtimin e ngrohtores së qytetit të Drenasit.

Neni 3

Pronat e paluajtshme të cilat do të këmbehen kanë këto karakteristika:

Propozimi i parë i pronave komunale për këmbim:

- P – 70315016-00829-1, me sip.11745 m², me kultur kullosë e kl.4, zona kadastrale Çikatovë e Vjetër, – pronë komunale, KK Glllogoc.
- P – 70315016-00829-2, me sip.59428 m², me kultur kullosë e kl.4, zona kadastrale Çikatovë e Vjetër, – pronë komunale, KK Glllogoc. Sipërfaqja për këmbim: 60000 m²

Propozimi i dytë i pronave komunale për këmbim:

- P - 70315016-00875-0, me sip.66130 m², me kultur kullosë e kl.3 , zona kadastrale Çikatovë e Vjetër,- pronë komunale, KK Glllogoc.
- P - 70315016-00876-0, me sip.29489 m², Tokë jo pjellore, zona kadastrale Çikatovë e Vjetër,- pronë komunale, KK Glllogoc. Sipërfaqja për këmbim: 60000 m²
- Propozimi i tretë i pronave komunale për këmbim:
- P - 70315016-00881-0, me sip.99648 m², me kultur kullosë e kl.5 zona kadastrale Çikatovë e Vjetër,- pronë komunale, KK Glllogoc.

Sipërfaqja për këmbim: 60000 m².

Pronat private për këmbim:

- P-70315016-00269-2, me sip.71105 m², me kultur kullosë e kl.3, zona kadastrale Glllogoc, pronë private, pronar Newco Ferronikeli Complex L.L.C., sipërfaqja për këmbim 20000m².
- P -70315016-01013-0, me sip.206767 m², me kultur kullosë e kl.3 dhe rrugë, zona kadastrale Glllogoc, pronë private, pronar Newco Ferronikeli Complex L.L.C. Sipërfaqja për këmbim 40000 m².

Sipërfaqja totale për këmbim 60000 m².

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Drenasit i cili do të inicon procedurën e mëtejme konform dispozitave ligjore në fuqi, për këmbimin e këtyre pronave në Zonat Kadastrale në Glllogoc dhe Çikatovë e Vjetër.

Neni 5

Vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës, dhe vlerësimi i pronës private, të cilat do të këmbehen do të bëhet nga Zyra për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme.

Neni 6

Mënyra dhe kushtet e këmbimit të këtyre pronave të paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të pronës private që do të këmbehet.

Neni 7

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadashtër dhe Pronë, që të përfundoj të gjitha procedurat e nevojshme gjeodezike, kadastrale që nevojiten për këmbimin e këtyre pronave.

Neni 8

Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: Çertifikatat e pronësisë, -Skicat

Neni 9

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Web faqen zyrtare të Komunës.

Plani i dërgohet;
Vendimi i dërgohet;
Zyrës së Kryetarit;
Drejtorisë Përkatëse;
Zyrës së Kuvendit;
Arkivit



Kuvendit të Komunës
Mëhmet Hajdari



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Glllogocit
Zyra e Kryetarit



01-Nr 400101-22196 dt. 11/05/2023

Në bazë të nenit 58 pika (h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72 paragrafi 1 pika (h) të Statutit të Komunës së Glllogocit, në bazë të nenit 5 nënparagrafi 1.2 pika 1.2.3, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.3, nenit 17 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.01/2018 për Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme, Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor. Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës, të miratoj këtë:

PROPOZIM VENDIM
PËR MIRATIMIN E PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM PËR QENDRËN E
QYTETIT-GLLOGOC

Neni 1

Miratohet vendimi i Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit-Glllogoc.

Neni 2

Planet Rregulluese të Hollësishme përcaktojnë kushtet për rregullimin e hapësirave për zona urbane apo rurale, siç është përcaktuar në Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale Komunale.

Neni 3

Zona për të cilën do të hartohet Plani Rregullues i Hollësishëm është Qendra e Qytetit Glllogoc dhe përfshinë një sipërfaqe prej $S=110.00$ Ha.

Neni 4

Plani Rregullues i Hollësishëm mbulon një periudhë së paku tetë (8) vjeçare.

Neni 5

Autoriteti për planifikim hapësinor është përgjegjës për zbatimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në bashkërendim dhe bashkëpunim me autoritetet tjera përkatëse sektoriale përgjegjëse.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Glllogocit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.



Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Me miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit për periudhën 2022-2030 të datës 24.06.2022, Komuna e Glllogocit është përcaktuar që përmes Hartës Zonale të Komunës të identifikojë zonat për të cilën kërkohet të hartohet Plani Rregullues i Hollësishëm, me vendim të kuvendit të komunës 02-Nr.030/01-46344 datë 31.08.2022, është filluar me hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit- Glllogoc për të përcaktuar kushtet për rregullimin e hapësirave për zonën urbane.

Me Vendimin 02-Nr.400/01-14932 datë 28.03.2023 të kuvendit të komunës, është miratuar vendimi për lënie në shqyrtim publik të projekt dokumentit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit- Glllogoc, në mënyrë që t'u lihet në dispozicion qytetarëve, agjencive, departamenteve dhe organeve të tjera për shqyrtim dhe komente për projekt dokumentin Plani Rregullues i Hollësishëm për Qendrën e Qytetit- Glllogoc.

Shqyrtimi publik i Projekt dokumentit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit- Glllogoc ka zgjat 30 ditë, sipas procedurave të përcaktuara me ligj. Pas përfundimit të kohëzgjatjes së shqyrtimit publik, projekt dokumenti së bashku me përmbledhje të shkurtër të komenteve të bëra gjatë diskutimit publik- raportin, do t'i dorëzohen kuvendit të komunës për shqyrtim dhe miratim përfundimtar.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
KOMUNA E DRENASIT
Zyra e Kryetarit



Nr. 01-400101-22607 Dt. 12/05/2023

Në bazë të nenit 58, paragrafi 1, pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 16, pika 11 të Ligjit Nr.08/L-198 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, Kryetari i Komunës së Drenasit propozon që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të rregullt të aprovoi:

PROPOZIM – VENDIM
RIALOKIM I MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

Propozim Vendim për rialokim të mjeteve financiare brenda nënprogramit Shërbimet e Shëndetësisë Primare (73100) dhe kategorisë së Shpenzimeve Kapitale (30).


Neni 2

Rialokimi i mjeteve bëhet nga projekti “Zgjerimi i QMF Arllat”, kodi 52311, në shumën 45,000.00 euro, burimi i financimit Grande Qeveritare (10) në Projektin “Veturë e ndihmës së shpejtë QKMF Drenas”, kodi 53726, burimi i financimit Grande Qeveritare (10), në shumën prej 45,000.00 euro.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.



KRYETARI I KOMUNËS

Ramiz Lladrovci

A r s y e t i m

Meqenëse Rregullorja për sistematizimin e vendeve të punës është në procedurë të finalizimit dhe qendra e AMF në Arllat i plotëson kriteret për ofrim të shërbimeve shëndetësore sipas numrit të banorëve resident si dhe duke parë nevojën për vetura të ndihmës së shpejtë të cilat janë tejet të vjetruara dhe jo funksionale, ky projekt të rialokohet për blerjen e një veture.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Nr. 01-400/01-22557 dt. 121051 2023

Në bazë të nenit 58, paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës"), Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2023, të aprovojë këtë:

PROPOZIM VENDIM
PËR RITJEN DHE BARTJËN E TË HYRAVE VETANAKE

Neni 1

Me këtë Propozim vendim, miratohet rritja dhe bartja e të hyrave vetanake nga viti 2022 në vitin 2023. Mjetet për rritje dhe bartje, janë të hyrat vetanake të pa shpenzuara gjatë vitit të kaluar dhe viteve tjera.

Neni 2

Të hyrat vetanake për rritje janë në shumë prej: **1,146,544.88 euro** dhe të hyrat e pa shpenzuara e që duhet të bartën nga fondi (21) janë në shumë prej: **270,627.97 euro** dhe nga fondi burimor (22) në shumë prej: **207,435.27 euro**.

Neni 3

Totali i mjeteve për rritje dhe bartje, në shumë prej: **1,624,608.12 euro** barten në këto kategori ekonomike:

Mallra dhe Shërbime	406,722.96 euro
Shpenzimet Komunale	24,000.00 euro
Subvencione dhe Transfere	29,853.81 euro
Shpenzime Kapitale	1,164,031.35 euro

Neni 4

Shuma e mjeteve për bartje nga rritja/tejkalmimi i realizimit të të hyrave kundrejt planifikimit dhe nga bilanci i pashpenzuar i fondit 21 nga viti paraprak , në nënprogramet dhe kategoritë e shpenzimeve si vijon:

Në kategorinë e shpenzimeve Mallra dhe Shërbime në nën programet si vijon:

Zyra e Kryetarit (16001) në vlerë prej:.....	54,391.47 €
Shërbimet e Shëndetësisë Primare (73100) në vlerë prej:	6,528.00 €
Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66310) në vlerë prej:.....	19,938.48 €
Infrastruktura Rrugore(18001) në vlerë prej:.....	12,361.49 €

Administrata (16301) në shumë prej:	30,000.00 €
Planifikimi i Zhvillimit Ekonomik (48001) në vlerë prej:	17,000.00 €
Infrastruktura Publike (18161) në vlerë prej:	20,000.00 €
Bujqësia (47001) në vlerë prej:	32,000.00 €
Arsimi Parashkollor (92210) në vlerë prej:	12,242.98 €
Administrat (92005) në vlerë prej:	108,642.60 €

Në kategorinë e Shpenzime Komunale në në programin:

Infrastruktura Rrugore (18001) në vlerë prej:	24,000.00 €
---	-------------

Në kategorinë e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere në nën programet si vijon:

Infrastruktura Rrugore (18001) në vlerë prej:	10,485.04 €
Administrata (73010) në vlerë prej:	12,083.01 €
Zyra e Kryetarit (16001) në vlerë prej:	617.56 €
Administrata (92005) në vlerë prej:	1,150.10 €

Në kategorinë e shpenzimeve Kapitale në nën programet dhe projektet si vijon:

Infrastruktura Rrugore (18001) në projektin:

“Rregullimi dhe kultivimi i sipërfaqeve gjelbëruese, druj dekorativ”, kod (53313) në vlerë prej:	5,751.00 €
--	------------

Infrastruktura Publike (18161) në projektet:

“Zgjerimi dhe ndërtimi i Sheshit “Fehmi e Xhevë Lladrovci” Drenas, kod (49297) në vlerë prej:	900,000.00 €
“Rregullimi i shtratit të lumit Drenica – Verbica”, kod (48254) në vlerë prej:	4,876.17 €
“Asfaltimi i rrugës në fshatin Arllat, Negroc, Gjergjicë si dhe Bytyq, kod (48646) në vlerë prej:	65,752.50 €
“Asfaltimi i rrugës Zabel i Ulët e Epërme, Korroticë e Ulët dhe Epërme”, kod (48658) në vlerë prej:	51,296.90 €
“Kanalizimi i ujërave të zeza Sankoc, Fushticë e Epërme dhe Ulët, kod (48705) në vlerë prej:	5,109.00 €
“Kanalizimi i ujërave të zeza Gllanasellë dhe Godanc”, kod (48710) në vlerë prej:	6,344.14 €
“Kanalizimi i ujërave të zeza Negroc, Kizhnarekë”, kod (48713) në vlerë prej:	4,669.00 €
“Kanalizimi i ujërave të zeza Shtuticë, Verbovc dhe Polluzhë”, kod (51323) në vlerë prej:	1,933.50 €

Arsim fillor, mesëm i ulët (93000) në projektin:

“Ndërtimi i fushave të jashtme sportive, rrethoja, Gelshani, Xh. Lladrovci dhe D. Drenices”, kod (53691)....	10,000.00 €
--	-------------

Neni 5

Shuma e mjeteve për bartje nga bilanci i pashpenzuar i fondit 22 nga viti paraprak, në nënprogramet dhe kategoritë e shpenzimeve si vijon :

Në kategorinë e shpenzimeve Kapitale në nën programet dhe projektet si vijon:

Infrastruktura Publike (18161) në projektin:

“Zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit “Fehmi e Xheva Lladrovci”, kod (49297) në vlerë prej:	108,299.14 €
--	--------------

Në kategorinë e shpenzimeve Mallra dhe Shërbime në nën programet si vijon:

Shërbimet Kadastrale (65005), në vlerë prej:.....	74,665.68 €
Administrata (16301), në vlerë prej:.....	2,806.42 €
Planifikim Urban dhe Inspeksioni (66310), në vlerë prej:.....	458.52 €
Shërbimet e Shëndetësisë Primare (73100), në vlerë prej:.....	108.00 €
Arsimi Parashkollor (92210), në vlerë prej:.....	15,579.32 €

Në kategorinë e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere në nën programet si vijon:

Infrastruktura Rrugore (18001), në vlerë prej:.....	4,168.20 €
Administrata (92005), në vlerë prej:.....	1,349.90 €



A r s y e t i m

Rritja e të hyrav vetanake në shumë prej: **1,146,544.88** euro është si rezultat i tejkalimit të të hyrave vetanake të planifikuara dhe në pamundësi për alokimin e tyre në vitin 2022, janë bart dhe do të perdoren për zhvillimin e projekteve të parapara për vitin 2023, ndersa mjetet e pa shpenzuara në vitin 2022 janë paraparë për mbulimin e projekteve të cilat kanë qenë dhe janë në zhvillim në vitin 2023.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
KOMUNA E DRENASIT
Zyra e Kryetarit



Nr. 01-400/01-22521 Dt. 12/08/2023

Në bazë të nenit 58, paragrafi 1, pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Neni 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, neni 16, pika 11 të Ligjit Nr.08/L-198 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, Kryetari i Komunës së Drenasit propozon që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të rregullt të aprovoi:

PROPOZIM – VENDIM

Neni 1

Propozohet riallokimi i mjeteve financiare brenda nënprogramit Shërbimet Kulturore (85001) dhe kategorisë së Shpenzimeve Kapitale (30) në shumën 300,000.00 euro.

Neni 2

Riallokimi i mjeteve bëhet nga projekti “Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës, Muze, Arkiv, Bibliotekë, Teatër (Galeri e arteve), Drenas, Terstenik, Komoran”, kodi 53732, nga burimet e fondeve Grande Qeveritare (10) në shumën 150,307.00 euro dhe nga të Hyrat Vetanake (21) në shumën 149,693.00 euro në projektin “Ndërtimi i stadionit- faza e dytë”, kodi 89114, burimi i financimit Grande Qeveritare (10) në shumën 150,307.00 euro dhe të Hyra Vetanake (21) në shumën 149,693.00 euro.

Neni 3

Me aprovimin e këtij vendimi shfuqizohet vendimit Nr. 02-400/01-18560 i datës 24.04.2023 i Kuvendit të Komunes së Drenasit për riallokimin e mjeteve financiare.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.



A r s y e t i m

Komuna e Drenasit me datë 24.04.2023 ka nxjerr vendimin Nr. 02-400/01-18560 per rialokimin e mjeteve financiare, mirëpo Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përmes Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal ka kërkuar nga ana e Komunës së Drenasit që të specifikohen saktë burimet e financimit. Me këtë rast në përputhje me rekomadimet e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, Kuvendit të Komunës së Drenasit i propozohen ndryshimet e lartcekura.

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arhiva - Arhiva - Archive

Mësia Org.
Org. Jedin.
Org. Unit: 02mgp

Nr. Prot.
Br. Prot.
Prot. No: 942/2023

Nr. i fletëve
Prot. Jedinica
No. pages: 05/05/2023

Datë: PRISTINE/A



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers*

Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës së Drenasit	
	Milaim Hajdari, Kryesues i Kuvendit të Komunës	
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal	
	Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	
	Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	
Përmes:	Resul Makreshi, Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve	
	Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	
Nga:	Klit Shala, Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Datë: 03.05.2023
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Bora Duli, Zyrtare e Lartë Ligjore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve 2. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor Kimete Zekaj, Zyrtare e Lartë për Politika Buxhetore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Referencë: 108/2023
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim të aktit të Komunës së Drenasit	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuari Kryetar z. Lladrovci,
I nderuari Kryesues z. Hajdari,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 Për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

Vendimin nr.02-400/01-18560, për transfer të mjeteve nga Projekti nr. 10/611/850010/300/53732/0820 kategoria e shpenzimeve kapitale në Projektin nr. 10/611/850010/300/89114/0820, në buxhetin e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
<i>I miratuar më datë 20.04.2022</i>
<i>I parashtritur për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 24.04.2023</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 25.04.2023</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtë e tutje referuar si "Ministria"), duke u bazuar vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë, si dhe pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërm të Komunës së Drenasit, jep konstatimet ligjore bazuar në këndvështrimet e mëposhtme:

1. Komuna e Drenasit, me anë të aktit që është subjekt i shqyrtimit ka synuar transferin e mjeteve nga Projekti nr. 10/611/850010/300/53732/0820 kategoria e shpenzimeve kapitale në Projektin nr. 10/611/850010/300/89114/0820, në buxhetin e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
2. Për qëllime të këtij vlerësimi, është relevante të theksohet se procesi i ndryshimeve të mjeteve financiare të ndara për projekte kapitale në kuadër të nën-programeve evidentohet edhe në legjislacionin që bie në fushëveprimin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, si por duke mos u kufizuar në dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 (këtë e tutje referuar si 'Ligji i Buxhetit 2023'), Udhëzimet Administrative Nr.04/2029 për Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve të Projekteve Kapitale dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2019 për Kriteret Përzgjedhëse dhe Prioritizimin e Projekteve Kapitale (këtë e tutje referuar si 'Udhëzimet Administrative').
3. Kështu, në kuptim të ndryshimeve në shumat e ndara buxhetore, neni 16, paragrafi 11 i Ligjit të Buxhetit 2023 përcakton se Komunitat mund të transferojnë dhe/ose alokojnë mjetet nga projektet kapitale, si në vijim:

Ndryshimet në shumat e ndara për projektet kapitale në kuadër të nën-programeve

11. Ndryshimet në shumat e ndara buxhetore për projektet ekzistuese si rezultat i transferëve dhe/ose rialokimeve, të prezantuara në tabelën 4.2., duke përfshirë edhe të hyrës vetanake të bartura, si dhe të regjistruara në SIMFK, duhet të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal, kurse në rastin e FZHM-së ndryshimet në shumat e ndara buxhetore duhet të aprovohen nga Bordi i FZHM-së. Ndryshimet e bëra të parapara me këtë nen regjistrohen në SIMFK nga Ministri.

4. Logjika e ndjekur me këtë dispozitë është se transferi/rialokimi brenda nën-programeve mund të realizohet vetëm atëherë kur kemi aprovim paraprak nga Kuvendi Komunal.
5. Nisur mbi premisat e këtij argumentimi, mbetet evidente se organizata buxhetore ka miratuar transferin/rialokimin e mjeteve nga projektet kapitale. Përkundër kësaj, Ministria ka vërejtur se komuna nuk ka bërë ndarjen e saktë të burimeve të financimit në vendim, dhe nuk ka vendosur emrat përkatës dhe kodet e projekteve, të cilat duhet të jenë ashtu siç janë të paraqitura në Ligjin e Buxhetit 2023.
6. Si përfundim, Ministria i rekomandon Komunës së Drenasit që për implementim korrekt të vendimit, të ndryshojë/plotësojë vendimin duke vendosur emrat përkatës dhe kodet e projekteve sipas Ligjit të Buxhetit 2023.

Marrë për bazë konstatimet e mësipërme, Ministria kërkon nga Komuna e Drenasit ndërmarrjen e veprimeve konkrete brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e kërkesës për rishqyrtim të aktit, në mënyrë që të dhënat e paraqitura me aktin komunal të harmonizohen me legjislacionin në fuqi.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Drenasit dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transferëve përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transferëve